



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova - Kosova Cumhuriyeti



**Komuna e Prizrenit**  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

**DREJTORIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT**

Prizren, 26.03.2026

**THIRRJE PUBLIKE**

**Për anëtarë të komisionit për vlerësimin e projekt propozimeve të OJQ-ve dhe Individëve në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.**

Bazuar në Rregulloren e Ministrisë së Financave Nr.: 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat financimit publik të OJQ-ve në Nenin 8, paragrafin 3.2 dhe Rregullores Komunale nr. 001/011-201 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve dhe Transfereve dhe Granteve, që pjesë e çdo Komisioni Vlerësues për vlerësimin e projekt propozimeve të OJQ-ve dhe Individëve të pranuar sipas thirrjes publike duhet të jetë një përfaqësues nga grupi i ekspertëve të jashtëm, duke përfshirë një përfaqësues të OJQ-ve.

Për këtë qëllim DKRS-ja fton të gjithë të interesuarit të aplikojnë për të qenë pjesë në cilësinë e anëtarit të Komisionit Vlerësues për të vlerësuar projekt propozimet e dorëzuara nga OJQ-të dhe Individët.

Të gjithë kandidatët të cilët nuk janë nën hetime apo me procedurë penale dhe që kanë përvojë në shoqëri civile me përparësi nga OJQ-të që merren me fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit mund të aplikojnë për pjesëmarrje në Komisionin Vlerësues në cilësi të :

1. Një përfaqësues nga OJQ-të ;
2. Një përfaqësues në cilësinë e ekspertit.

**Të drejtë aplikimi kanë :**

- Të angazhuarit në Organizatat jo-qeveritare aktive që veprojnë në Komunën e Prizrenit ;
- Ekspert të pavarur të cilët kanë përvojë pune që ndërlidhet me hartimin dhe menaxhimin e projekteve në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

**Kandidatët duhet të plotësojnë këto kushte :**

- Duhet të kenë të diplomë universitare ;
- Të ketë përvojë në hartimin dhe menaxhimin e projektetve të OJQ-ve kulturore, rinore dhe sportive;
- Të mos jenë të emëruar politik, shërbyes civil apo pozita të ngjashme në administratën shtetërore.

**Kandidatët duhet të dorëzojnë këto dokumente :**

- Një CV ;
- Përfaqësuesi nga OJQ-të duhet të dorëzoj një letër nominimi nga udhëheqësi i OJQ-së në të cilën dëshmohet se aplikuesi është i punësuar apo i angazhuar në organizatë
- Përfaqësues në cilësinë e ekspertit duhet të kenë diplomë universitare .

Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen, në adresën e mëposhtme:

Komuna e Prizrenit  
Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit  
Sporteli nr.:1- 5 në ndërtesën e Komunës,  
20000 Prizren

*Afati i apikimit nga data 26.03.2026 deri më datën 06.04.2026*

Komisioni i themeluar nga DKRS-ja do t'i vlerësoj të gjitha aplikacionet e pranuar dhe kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara përmes kësaj ftese publike do të jenë pjesë e Komisionit Vlerësues për subvencionimin e Ojq-ve dhe Individëve për vitin 2026.

V.v.

Drejtoreshë e DKRS-së  
Ajlin Shishko Hajdari

